



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 446/2 prot.

Pukë, më 25.03.2026

VENDIM

Nr. 12 datë 25.03.2026

“PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE NË BASHKINË PUKË”

Këshilli Bashkiak Pukë, në mbledhjen e radhës të datës 25.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Pukë “Mbi miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike”, dhe në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar; VKM nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e sigurisë publike, në përfundim;

VENDOSI:

- I. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Pukë.
- II. Këshilli Vendor për Sigurinë Publike përbëhet nga:
  1. Kryetari i Bashkisë Pukë
  2. Shefi i Komisarariatit të Policisë Pukë;
  3. Shefi i Policisë Bashkiake;
  4. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Emergjencave Civile në Bashki;
  5. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
  6. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
  7. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor,
  8. Përfaqësues i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
  9. Përfaqësues i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
  10. Përfaqësues i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (Drejtoria Rajonale);
  11. Përfaqësues i administratës rajonale të zonave të mbrojtura,
  12. Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marredhëniet familjare,
  13. Përfaqësues i njesisë për mbrojtjen e fëmijëve,
  14. Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit,
  15. Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
- V. Vendimi u shpall me date 25.03.2026  
Vota të vlefshme gjithsej 11  
Vota pro 11, Vota kundër 0, Vota abstenim 0

SEKRETARI  
Hazbi Terbuni

KRYETARI  
Gjon GJOKA

01.04.26

selc /cshllit  
F. Ruzica  
S. Jureq  
P. Duda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Keshillit  
446/4  
03.04.2026  
REPUBLICA E SHQIPËRI  
SEKRETARI  
BASHKIA P

Nr. 231/1 prot.

Shkodër më 31.03.2026

**LËNDA:** Mbi vendimin 12, datë 25.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë

### KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshua, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29, neni 54 germa “n”, VKM nr. 678 datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendore të sigurisë publike” të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 466/4 prot., datë 26.03.20256 “Dërgojmë vendimet e Këshillit Bashkiak Pukë të datës 25.03.2026”, shqyrtoi VKB nr. 12 datë 25.03.3026 “Për miratimin e krijimit të këshillit vendor për sigurinë publike në bashkisë Pukë”

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



**PREFEKTI**

**Holta DUDA**